

VENDIM
Nr. 385, datë 28.5.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 475, DATË 8.6.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK
TË NATO-s NË LETONI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5, e vendimit nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31.12.2029, me sistem rotacioni. Kohëzgjatja për çdo rotacion është deri në 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2026.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama